

VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 22 tetor 2001, unë E. Buj, gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studjova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga Z. Georgios Papageorgiou dhe Z. Dimitris Gavriil në cilësinë e Administratorëve të Shoqërisë "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK, për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK është person juridik i së drejtës shqiptare e regjistruar me Vendimin Nr. 22438, datë 15 dhjetor 1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, dhe ka për Ortak të Vetëm shoqërinë "GLOBAL PETROLEUM ALBANIA" SHA.

Me vendimin e dates 15 dhjetor 1999, të Mbledhjes së Asamblese së Jashtezakonshme të Ortakeve të shoqërisë "GLOBAL" SHPK, është marrë vendimi për të transferuar veprimtarinë tregtare të shitjes dhe blerjes së karburanteve me pakice të shoqërisë "GLOBAL" SHPK tek shoqëria "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK duke perjashtuar kalimin e borxheve.

Me vendimin e dates 16 dhjetor 1999, të Mbledhjes së Asamblese së Jashtezakonshme të Ortakut të Vetëm të shoqërisë "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK, është marrë vendimi për pranimin e transferimit të veprimtarisë tregtare të shitjes dhe blerjes së karburanteve me pakice të shoqërisë "GLOBAL" SHPK tek shoqëria "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK.

Për transferimin e veprimtarisë tregtare të shitjes dhe blerjes së karburanteve me pakice të shoqërisë "GLOBAL" SHPK tek shoqëria "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK duke perjashtuar kalimin e borxheve është nënshkruar edhe deklarata noteriale e dates 7 qershor 2000 ndërmjet dy shoqërive "GLOBAL" SHPK dhe "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK.

PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e cmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e Kërkesës;
- Depozitimin e: i) Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK të datës dates 16 dhjetor 1999 për pranimin e

transferimit te veprimtarise tregtare te shitjes dhe blerjes se karburanteve me pakice te shoqerise "GLOBAL" SHPK tek shoqeria "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK; ii) Vendimit te dates 15 dhjetor 1999, te Mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "GLOBAL" SHPK per transferimin e veprimtarise tregtare te shitjes dhe blerjes se karburanteve me pakice te shoqerise "GLOBAL" SHPK tek shoqeria "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK, duke perjashtuar kalimin e borxheve; iii) te deklarates noteriale te dates 7 qershor 2000 ndermjet dy shoqerive "GLOBAL" SHPK dhe "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK per transferimin e veprimtarise tregtare te shitjes dhe blerjes se karburanteve me pakice te shoqerise "GLOBAL" SHPK tek shoqeria "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK duke perjashtuar kalimin e borxheve.

- Urdhërohet zyra e Regjistrimit Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të shoqërisë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE

G. Ryzh
Arshani